S T A T U T I

I

SHOQERISE PRODHUESE E TREGTARE "PERLLAKU " SHPK.

Ne baze te ligjit 7512,date 10.08.1991 " Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private,nismes se lire,veprimtarise private te pavarur dhe te privatizimit ",ne Tirane,sot me daten 3.05.1993,shtetasi Hazbi Perllaku,i biri Selimit dhe Lazes,i datlindjes 1955,banues Lagja 7,Rruga " Mihal Grameno ",Nr. 212 Tirane,me vullnetin e tij te lire e te plote,ne perputhje me legjislacionin shqiptar vendosi te krijoje Shoqerine Prodhuese e Tregtare Private me Pergjegjesi te Kufizuar " PERLLAKU " Tirane.

K R E U I

**********

Shoqeria Prodhuese e Tregtare " PERLLAKU " SHPK Tirane eshte person juridik i pavarur,ka te drejta dhe detyrime per te cilat pergjigjet brenda kufijve te percaktuar ne ligjin 7512,date 10.08. 1991,Kodin Tregtar dhe akte te tjera ligjore. Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne baze te ekonomise se tregut te lire.

Themeluesi i saj ne kete sipermarrje ka derdhur kapitalin e tij,me qellim qe te perfitoje te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private,si dhe te perballoje humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne kapitalin themeltar.

EMRI,QENDRA,TERRITORI

NENI 1

Emertimi i shoqerise do te jete :
SHOQERIA PRODHUESE E TREGTARE " PERLLAKU " SHPK Tirane.

NENI 2

Selia e shoqerise eshte ne adresen :

Lagja 7,Rruga " Mihal Grameno ",Nr.212 Tirane.

Shoqeria mund te zhvilloje aktivitetin e saj ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

NENI 3

Shoqeria " PERLLAKU " SHPK Tirane eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar me rregjistrimin ne Gjykaten e Rrethit Tirane dhe pajisjes me lejen e ushtrimit te profesionit nga Zyra e Tatimeve te Rajonit Nr.1 Tirane.

OBJEKTI

NENI 4

Objekt i veprimtarise prodhuese e tregtare do te jete :

* Tregtim me shumice e pakice eksport - import te mallrave industriale,ushqimore,bujqesore,blegtorale,te artizanatit,etj;
* Prodhim artikuj ushqimore,bujqesore e blegtorale,etj;
* Prodhim materiale ndertimi;

* Investim e ndertim te objekteve industriale e socialkulturore agjenci turistike,etj;
* Tregtim makineri,pajisje,pjese nderrimi per automjete,etj;
* Sherbime hotelerie,turistike,restorante,bar,etj;
* Transport mallra e pasagjere;
* E tjera.

AFATI I VEPRIMTARISE

NENI 5

Aktiviteti privat i shoqerise do te zhvillohet me nje afat te pacaktuar,mbi 10 vjet.

NENI 6

Shoqeria eshte e detyruar te mos ndryshoje destinacionin.
Ndryshimi i destinacionit brenda 2 vjeteve behet me lejen e Agjencise Kombetare te Privatizimit.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 7

Kapitali themeltar i shoqerise " PERLLAKU " SHPK Tirane perbe het nga kontributi fillestar i themeluesit te shoqerise ne vleften 100.000 leke. Kapitali mund te ritet me zhvillimin e veprimtarise ekonc mike te shoqerise.

NENI 8

Zvogelimi i kapitalit themeltar ne nje vlere me te vogel se 100.000 leke e detyron shoqerine te shnderrohet ne nje forme tjeter,ne rast se ajo nuk merr vendim per rritjen e kapitalit themeltar te pakten deri ne vleren e mesiperme.

NENI 9

Transferimet e kapitalit themeltar duhet te vertetohen me akt noterial.Shoqeria apo te tretet duhet te respektojne keto transferi me sapo t'i behen te ditura asaj.

NENI 10

Pjeset e kapitalit themeltar jane te transferueshme ne rruge trashegimie.Ato mund t'u kalojne bashkeshorteve,paraardhesve dhe pasardhesve.

NENI 11

Pjese te kapitalit themeltar mund t'i transferohen edhe personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri me pelqim te themeluesit te shoqerise. Ne rast te shtimit te numerit te ortakeve,me miratimin e shumices se ortakeve,qe perfaqesojne te pakten 3/4 e pjeseve te kapitalit themeltar.

NENI 12

Ne rast te shtimit te numerit te ortakeve,me marreveshje pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet tyre.

DREJTIMI ADMINISTRATIV

NENI 13

Shoqeria " PERLLAKU " SHPK Tirane do te kete si administrato z.Hazbi Perllaku,i cili eshte ortaku i vetem themelues i shoqerise.Ai ka te drejte te caktoje si administrator edhe persona te tjere ne ve d te tij,te cilet nuk e kane cilesine e ortakut.

NENI 14

Administratori ka per detyre organizimin dhe drejtimin e veprimtarise se shoqerise.Ai mund te kryeje te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise.

NENI 15

Ne marredhenie me te tretet administratori angazhon shoqerine nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.Ne rastet kur administratori eshte i emeruar nga themeluesi i shoqerise,kryen te gjitha veprimet e administrimit te shoqerise me perjashtim te atyre qe jane ne kompetencen e themeluesit te shoqerise.

NENI 16

Ortaku i vetem themelues ka ne kompetence :

* Te miratoje programin ekonomik,raportin e administrimit te shoqerise,inventaret,llogarite vjetore,te cilat hartohen brenda 6 muajve,duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.Keto vendime i merr pasi materialet e mesiperme i paraqiten nga admnistratori i zgjedhur prej tij,ose ndonje ekspoert kontabel,i ngarkuar posaçerisht.
* Vendos per shperberjen e shoqerise.
* Vendos per ndarjen e fitmeve dhe mbulimin e humbjeve.
* Rregullon marredheniet e punesimit dhe te shperblimit brenda shoqerise.
* Sipas akteve ligjore shlyen detyrimet ndaj organeve shteterore dhe personave juridike e fizike vendas a te huaj.
* Te tjera.

NENI 17

Ne rast se administrimi i shoqerise do te behet nga nje administrator i zgjedhur posaçerisht nga ortaku themelues,ky i fundit ka te drejte te informohet ne çdo kohe personalisht per veprimtarine e shoqerise,si dhe te njihet me llogarite dhe dokumentat e shoqerise.

NENI 18

Administratori shkarkohet nga detyra e ngarkuar ne rast te prishjes se shoqerise,ose kur shkarkohet nga ortaku i vetem themelues i shoqerise.Ne rastin e fundit,shkarkimi i administratorit behet ne baze te nje akti me shkrim.Ne rast se shkarkimi behet pa,te drejte ai le shkak per demshperblim financiar.

K R E U II
***********

MARREDHENIET EKONOMIKE FINANCIARE

NENI 19

Shoqeria " PERLLAKU " SHPK mund te lidhe kontrata me sektoret shteterore,drejtperdrejt ne tregun e lire,si dhe me persona juridike e fizike vendas a te huaj,sipas legjislacionit ne fuqi per eksport importin.

NENI 20

Ne veprimet kontraktuale shoqeria perfaqesohet nga administratori z.Hazbi Perllaku,ose persona te tjere te autorizuar prej tij.

NENI 21

Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine dhe punonjesit e saj.

NENI 22

Sipas rregullave te caktuara nga Ministria e Financave dhe akteve te tjera ligjore,shoqeria pergjigjet per kontributin fiskal.

afatet e derdhjes se tij,detyrimet ndaj shtetit,sigurimet shoqerore, etj..Sipas ligjit mbi " Tatimin " percaktohen tatimet per veprimtarine prodhuese e tregtare.

NENI 23

Shoqeria ka te drejte te çele llogari likujduese prane bankave te vendit,te huaja ne Shqiperi dhe te kryeje veprimet e likujdimit nepermjet tyre.

NENI 24

Per sigurimin e veprimtarise ekonomike shoqeria ka te drejte te vetfinancohet ne leke ose valute te huaj.

NENI 25

Shkembimin e monedhes shqiptare me monedhe te huaj dhe anasjelltas mund ta beje ne perputhje me kursin e caktuar nga Banka e Shtetit Shqiptar ose ne tregun e lire privat te valutes.

NENI 26

Te ardhurat nga veprimtaria private,do te sigurohen sipas cmimeve qe cakton vete shoqeria.Cmimet dhe tarifat do te caktohen sipas kerkeses e ofertes.

NENI 27

Per pasqyrimin e aktivitetit prodhues e tregtar,adminitratori ose persona te tjere te aktuar nga ortaku i vetem themelues,jane te detyruar te mbajne dokumentacion te rregullt financiar dhe rregjistrat perkates sipas ligjit te vecante.

NENI 28

Veprimtaria ekonomike e shoqerise mbaron ne muajin Dhjetor te çdo viti.Administratori eshte i detyruar te paraqese bilance periodike,bilance vjetore sebashku me deklaraten e te ardhurave te fitimeve dhe te humbjeve dhe t'i depozitoje ato ne organin financiar te juridiksionit perkates ku ushtron aktivitetin shoqeria.

## K R E U III
************

MARREDHENIET E PUNESIMIT

NENI 29

Themeluesi i shoqerise vendos per shtimin e numerit te ortakeve dhe personave te tjere qe do te punesohen ne veprimtarine e shoqerise " PERLLAKU " SHPK Tirane.

NENI 30

Marredheniet e punesimit brenda shoqerise rregullohen sipas kontrates qe lidhet lirisht midis paleve.Kontrata leshohet nga administratori i shoqerise,pasi te jete marre me pare pelqimi i themeluesit te shoqerise,ose nga vete ortaku i vetem themelues qe ka edhe detyren e administratorit.

NENI 31

Marrja ne pune nga punedhenesi behet me rregjistrimin e punjesve ne librin e punes te shoqerise,si dhe duke njoftuar organet e punes te juridiksionit ku e ushtron aktivitetin shoqeria.

7

NENI 32

Ortaket ne rast se shtohet numeri i tyre,administratori dhe punonjesit e tjere te shoqerise jane te detyruar te respektojne disiplinen e punes dhe mbajne pergjegjesi per thyerjen e saj.

NENI 33

Nda personave qe demtojne pronen e shoqerise zbatohen masa ndeshkimore te cilat percaktohen nga themeluesi i shoqerise dhe ne mungese te tyre zbatohen dispozitat e Kodit te Punes te Republikes se Shqiperise.

NENI 34

Kontrata e punes mund te lidhet me ose pa afat te caktuar, sipas kritereve te percaktuara nga ortaku i vetem themelues,ose nga ortaket kur jane disa te tille,dhe ne mungese te parashikimeve ne kontrate te sipas ligjeve te shtetit shqiptar.

NENI 35

Punonjesit gezojne leje vjetore dhe leje plotesuese sipas kritereve te percaktuara ne kontraten e punes dhe ne mungese te tyre sipas Kodit tePünes te Republikes se Shqiperise.

NENI 36

Ndryshimi dhe Iargimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga ortaku themelues z. Hazbi Perllaku.Largimi lidhet me mberimin e kontrates se punes,per shkak te shkeljeve disiplinore ose me vete kerkesen e te interesuarit.

NENI 37

Punonjesi qe largohet ose transferohet ne nje pune tjeter, duhet te beje dorezimet e detyres ne nje akt me shkrim,pasi te kete likujduar detyrimet materiale e monetare. Akti i mesiperm mbahet nga administratori i shoqerise.

ELEMENTE TE TJERA

NENI 38

Per zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarise ekonomike prodhuese e tregtare,shoqeria mund te marre truall per ndertim mr qera dhe ne pronesi,si dhe objekte te ndertuara sipas nje kontrate te vecante.

NENI 39

Dhenia e truallit dhe e objekteve dhe vlefta perkatese e tyre percaktohen nga organi financier ne juridiksionin e te cilit ndodhet trualli ose objekti,ne baze te kritereve te Keshillit te Ministrave dhe sipas kerkeses e ofertes ne marreveshje me persona juridike e fizik vendas.

K R E U IV

***********

BILANCI DHE TE ARDHURAT

NENI 40

Te ardhurat neto,pas shlyerjes se detyrimeve fiskale,sigurimeve shoqerore etjera kalojne ne pronesi te ortakut themelues,ose te ortakeve ne se ka te tille dhe ndahen sipas kontributit te secilit.

NENI 41

Shperblimi per administratorin dhe personat e punesuar ne veprimtarine e shoqerise "PERLLAKU " SHPK Tirane, aktohet sipas kontrates se punes. Ndryshimi ne page vendoset nga themeleuesi i shoqerise, ose nga ortaket ne rast se shtohet numeri i tyre.

NENI 42

Shoqeria perballon humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre fillestar ne kapitalin baze.

NENI 43

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur ose shtuar shumat respektive te humbjeve apo fitimeve te bartura nga vitet e meparshme.

NENI 44

Kur pushon aktiviteti i shoqerise, kapitali i mbetur pasi shlyen te gjitha detyrimet ndahet midis ortakeve sipas kontributit te secilit ose i mbetet ortakut te vetem themelues kur nuk ka te tjere.

NENI 45

Fitimi i mbetur kalon ne pronesi te ortakut te vetem themelues pasi jane shlyer te gjithe detyrimet tatimore, si dhe pagesat e mundshme per punonjesit e shoqerise.

SHPERBERJA E SHOQERISE

NENI 46

Ne rast se kapitalet per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentat fiskale(financiare) rezultojne me te vogla se gjysma e kapitalit themeltar, ortaku themelues vendos brenda 4 muajve nga dita e konstatimit mbi mundesine e prishjes se parakohshme te shoqerise dhe te kerkoje ne gjykate prishjen e saj.

NENI 47

Gjyykata mund t'i afroje shoqerise nje afat maksimal prej 6 muaj per te rregulluar gjendjen. Ajo nuk mund te shpalle prishjen e shoqerise ne rast se ky rregullim eshte bere diten ne te cilen ajo mblidhet per te marre vendim.

NENI 48

Ne rast se shoqeria nuk prishet, detyrohet te zvogeloje kapitalin e saj ne nje vlere jo me te vogel se ajo e, humbjeve qe kane mbetur te pa mbuliara, duke patur parasysh qe shuma e kapitalit te mbetur te jete 100.000 leke.

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 49

Themeluesi ne rastin e shtimit te numerit te ortakeve, ka te drejten te beje ndryshimet e nevojshme ne statut, si dhe te hartoje edhe kontraten e perbashket me ortaket e tjere, duke bere ndryshimet e nevojshme ne rregjistrin tregtar prane gjykates se rrethit Tirane, etj.

NENI 50

Mosmarreveshjet e shoqerise ne me redhenie me persona juridike e fizike vendas e te huaj, zgjidhen ne mirekuptim, ne te kunderten, kur kjo nuk arrihet, zgjidhet nga gjykata e rrethit Tirane.